

Lidhjet mes Akademisë Sllovene dhe kësaj të Kosovës **- 40-Vjetori i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës** Albanologjia nga Fran Miklloshiçi deri më sot

Andrej Kranjc

anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve

Pikërisht në fund të vitit që shkoi, Akademia e Kosovës - Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK) – kremtoi 40-Vjetorin e saj. Qe themeluar në kohën, kur ishte për Serbinë taktikisht, që të ketë secila nga Krahinat e saj Akademi të vetën. Ndonëse nuk ka dalë plotësisht nga mjedisi i saj, megjithatë ka vepruar deri në rënien e Jugosllavisë përkatësisht Luftës në Kosovë.

Kështu Akademinë e Shkencave dhe të Arteve e ka themeluar para katër deçenieve Kuvendi i Kosovës, ndërsa Ligjin për mbylljen e saj e ka shpallur Kuvendi Serb. Atëherë ASHAK-u e pat humbur ndërtesën, që iu mor (me dhunë), pjesërisht e dëmtuar dhe asnjëherë e kthyer, ku kishte material të pasur arkivor, letrar e dokumentar, e disa anëtarë i qenë arrestuar dhe për një kohë edhe mbajtur në burg.

Por Akademia nuk qe shpartallua , veçoi në një shtëpi private të dhënë në dispozicion nga një anëtar i saj. Pas Pavarësisë i qe ndarë një ndërtesë e bukur historike, por e vogël. Ndërsa, para disa vitesh qenë ndërtuar për Akademinë dhe Ministrinë për Arsim, Shkencë e Teknologji, dy ndërtesa bashkëkohore simotra në qendrën e ngushtë të (krye)qytetit.

Dhe, çfarë i lidhë mes veti Akademinë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve (SAZU-ASSHA) me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK)? Intelktualët Kosovarë kanë pasur qysh para themelimit të ASHAK-ut kontakte relativisht të ngushta me Slloveninë. Aktualisht janë në mesin e tyre katër që kanë studiuar/magjistruar përkatësisht doktoruar në Slloveni; dy prej tyre, doktori i medicinës dhe kompozitori i kanë pasur për mentorë anëtarët e ASSHA, kirurgun tonë të njohur Vinko Dolenc dhe të ndjerin (kompozitor) Lucijan M. Shkerjanc. Edhe kryetari aktual i ASHAK, dr. Hivzi Islami ka doktoruar në Slloveni. Për këtë është krenare jo vetëm ASSHA, por edhe Universiteti i Lublanës.

Ndërkaq, kontakte më serioze mes akademive u bënë përafërsisht para dhjetë vjetëve, kur anëtari i ASHAK-ut, linguisti Rexhep Ismajli dhe Marko Snoj, bashkëpunëtor i Institutit të Gjuhës Sllovene “Fran Ramovsh” QSHS e ASSHA, aktualisht anëtar jo i rregullt i ASSHA, iu kanë përveshur përpunimit të punimeve të Gjuhës Shqipe të sllavistit tonë Fran Miklloshiçi.

Vërtetë, edhe për sllavistët është e përfitueshme dhe me rëndësi studimi i Gjuhës Shqipe. Si fryt i këtij bashkëpunimi është dalja më 2007 e botimit të përbashkët të ASHAK dhe ASSHA – libër voluminoz me 504 faqe – Gjurmime Shqiptare – Albanische Forschungen. Miklloshiçi-i nuk është marrë kalimthi me Gjuhën Shqipe, për më tepër vepra e tij është me domethënie bazike për vetë Shqipërinë, siç e konstaton specialisti (i gjuhës Shqipe) Mahir Domi.

Krahasime

Por le të kthehemi (paksa) edhe tek historia e ASSHA. Kryetari i parë i saj Rajko Nahtigal ishte po kështu linguist - sllavist dhe qe marrë gjithashtu me Gjuhën Shqipe.

Librin me kontributet/punimet mbi Gjuhën Shqipe të tij e kanë përgatitur me shpjegime të themelta po këta dy autorë, Ismajli dhe Snoj dhe në qershor 2015 ka dalur sërish si botim i përbashkët i AShAK dhe ASSHA. Dy të përmendurit gjuhëtarë të mirënjohur Sllovenë të shek. 19 dhe 20 janë pra vërtetë më të merituarit si shembull për bashkëpunim aktiv mes dy Akademive. Prandaj s'është për t'u habitur që, gjatë festimit të 40-vjetorit, përfaqësuesi i ASSHA u pranua ngrohtësisht dhe me respekt.

Edhe akademikët e Kosovës nuk janë të kënaqur me këtë si i sheh opinioni i gjerë (kjo m'i kujton shkrimet e gazetave Sllovene mbi ASSHA) përkundër veprës kaq të rëndësishme që po e bëjnë, të rëndësishme edhe për zhvillimin dhe përparimin e popullit të Kosovës. Le të përmend që e ka AShAK edhe grupin e posaçëm, që merret me programin afatgjatë të Enciklopedisë së Kosovës. Ngjashëm është edhe me përgatitjet e Fjalorëve.

Ndërkaq, në Slloveni kurrsesi s'po mund të vendosemi, kujt t'ia besojmë programin përgatitor të Fjalorit të Gjuhës Sllovene dhe si të vijmë deri te qëllimi që ky të mos jetë vetëm projekt trevjeçar. Në vendet, ku i kanë të zhvilluara sado-kudo Akademitë, kështu edhe në Kosovë, janë veprat e tilla në kuadër ose së paku nën patronatin e Akademive.

Edhe kjo është një nga arsytet që 40-Vjetori i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës në vendin e tyre pati jehonë më të madhe e të dukshme se sa para disa vitesh 75-vjetori i Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve. Në solemnitete morën pjesë një varg kryetarësh të Akademive të huaja, përfaqësuesin e saj e kishte dërguar edhe Unioni i Akademive Evropiane (ALLEA). Se u grumbulluan shumë fotografë, incizues e gazetarë është e kuptueshme, meqë ishin në mesin e folësve të tërë kreu politik i Kosovës – Kryetarja e Shtetit, Kryeministri, Kryetari i Kuvendit, si dhe Ministri për Arsim, Shkencë e Teknologji. Është çështje e vlerësimit a është pozitive ose jo për Akademinë, por është gjithsesi me rëndësi që një anëtar i rregullt është Kryeministër i Shtetit, kurse ministër anëtar korrespondent që i bie te ne njësoj me titullin/thirrjen anëtar jo i rregullt.

Ndërkaq, pjesëmarrja Sllovene nuk qe me rëndësi vetëm për pjesëmarrje në solemnitete; aktivitetet e këtilla janë edhe raste për kontakte të reja dhe thurje bazash për bashkëpunim, konkretisht vazhdime në fushën e gjuhësisë (edhe Jernej Kopitar-i e ka çmuar studimin e Gjuhës Shqipe), kështu, mbase edhe në ndonjë fushë tjetër që është me interes për të dy Akademitë.

Në bazë të punës së studiuesve dhe akademikëve tanë të shekujve të kaluar është zhvilluar brenda një 10-vjetshi një bashkëpunim i ngushtë pune mes dy Akademive. Brezit të tashëm e të ardhshëm u mbetet që t'i vazhdojnë dhe forcojnë kontaktet, sepse materia, që do t'i interesonte të dy palët, nuk mungon. Mbase do të jetë e mundur për të lajmëruar ndonjë gjë të re lidhur me këtë në krenimin që po afrohet të 80-Vjetorit të Akademisë Sllovene të Shkencave dhe të Arteve.